



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 75/8 prot.

Tiranë, më.22.5.2025

V E N D I M

Nr.23, datë 22.5.2025

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, NË
LIDHJE ME VEPRIMET E KRYERA NGA ANA E SUBJEKTEVE TË
NGARKUARA PREJ LIGJIT, ME DETYRA SPECIFIKE GJATË REALIZIMIT
TË PROCESIT TË VLERËSIMIT TË REZULTATEVE NË PUNË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil, në institucionin e Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë,

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është regjistruar informacioni me shkresën nr. 75/3 prot., 7.3.2025, të paraqitur nga nëpunësi Alfred Çausi, me detyrë “Drejtör”, pranë Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor, në lidhje me disa pretendime për parregullsi në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil në procedurën e vlerësimit të rezultateve në punë, për periudhën e vlerësimit 1 Korrik - 31 Dhjetor 2024.

Në përmbajtjen e informacionit të përcjellë dhe të dokumentacionit të administruar bashkëlidhur tij, provohet se, punonjësi Alfred Çausi, aktualisht kryen detyrën e Drejtorit të Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor dhe është nëpunës civil në nivelin e mesëm drejtues.

Në vijim të marrëdhënies së punësimit në këtë pozicione pune, në zbatim të detyrimit të parashikuar në nenin 62, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar, nga ana e eprorit direkt, është kryer vlerësimi i rezultateve në punë për 6 mujorin e dytë të vitit 2024, konkretisht për periudhën 1 Korrik - 31 Dhjetor 2024, për këtë nëpunës, në nivelin 2, *“Mirë”*. Duke mos qenë dakord me vlerësimin, nëpunësi në fjalë, në mbështetje të pikës 1, të kreut V, të aktit nënligjor të përmendur më sipër, ka kërkuar shqyrtim të vlerësimit nga zyrtari autorizues.

Në vijim të procedurës, zyrtari autorizues ka kryer procesin e rivlerësimit, duke e vlerësuar nëpunësin me të njëjtin nivel vlerësimi 2 *“Mirë”*, si dhe e ka njoftuar këtë të fundit për rezultatin e rivlerësimit, në datën 26.2.2025. Nëpunësi është shprehur se, nuk është dakord me vlerësimin, fakt të cilin e ka pasqyruar në plotësimin e pikës 2, të nëndarjes D, të formularit të vlerësimit.

Në lidhje me këtë proces të administrimit të shërbimit civil, nëpunësi pretendon se, procedura e vlerësimit të rezultateve në punë është kryer në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar, pasi, nuk janë respektuar elementët thelbësor të procedurës, të cilët kanë ndikuar në arritjen e konkluzioneve të padrejta, në vlerësimin e performancës në punë të këtij nëpunësi.

Konkretisht, nga ana e nëpunësit parashtrohet se, ky vlerësim ka qenë i pa argumentuar dhe i pabazuar në një analizë objektive të rrethanave dhe ecurisë së punës, duke mos respektuar të drejtat e nëpunësit civil, si dhe fazat e vlerësimit, sipas përcaktimeve në ligj dhe në aktet nënligjore.

Në këto kushte, është kërkuar ndërhyrja e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit, me detyra specifike gjatë realizimit të procesit të vlerësimit të rezultateve në punë.

Me qëllim verifikimin e rastit, me marrjen e këtij informacioni, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, bazuar në pikën 1, të nenit 14, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, ka nisur procesin e verifikimit me shkresën nr. 75/5 prot., datë 26.3.2025, *“Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e informacionit të dërguar pranë Komisionerit nga nëpunësi Alfred Çaushti, për vlerësimin e ligjshmërisë së procedurës së vlerësimit”* duke vënë në dijeni institucionin e Ministrisë së Drejtësisë, për fillimin e verifikimit të informacionit të administruar, si dhe duke kërkuar dokumentacionin e nevojshëm në të cilin materializohet procedura e vlerësimit të rezultateve në punë.

Në përgjigje të kësaj kërke, institucioni, nëpërmjet shkresës nr. 1806/1 prot., datë 3.4.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm, “*Kthim përgjigje mbi kërkesën për dokumentacion në lidhje me procedurën e vlerësimit të rezultateve në punë për z. Alfred Çausi”*, protokolluar pranë Komisionerit me nr.75/6 prot., datë 4.4.2025, ka paraqitur sqarimet përkatëse për rastin konkret.

Sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, vlerësimi i rezultateve në punë është procesi i a)verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuara në fillim të periudhës së vlerësimit, si edhe i b)aftësive ose dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, i cili realizohet çdo 6 muaj.

Referuar kreut IV, të vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar, vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civilë bëhet sipas lidhjes nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

Në rastin e punonjësit Alfred Çausi, me detyrë “*Drejtor*”, pranë Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor, konstatohet se, formulari i vlerësimit të punës është hartuar rregullisht, sipas lidhjes nr. 2, të aktit nënligjor të përmendur më sipër, duke respektuar edhe afatin ligjor të përcaktuar në këtë akt (*hartuar në datën 15.1.2025*).

Duke marrë në analizë mënyrën se si janë plotësuar ndarjet e formularit, (*ndarjet A, B, C, Ç, D e DH*), nga zyrtarët që ligji i ka ngarkuar me kompetencën e vlerësimit periodik, konstatohet sa më poshtë:

Ndarja A: Të dhënat personale

Në këtë ndarje janë plotësuar të gjitha të dhënat personale të nëpunësit: emri/mbiemri, pozicioni, institucioni, njësia organizative, drejtoria, vendndodhja, data e emërimit në pozicionin aktual, periudha e vlerësimit: 1 Korrik – 31 Dhjetor 2024, data e vlerësimit, është përcaktuar Zyrtari Raportues, si dhe është shënuar qëllimi i kryerjes së këtij veprimi administrativ, që është vlerësimi 6 mujor i rezultateve në punë.

Ndarja B: Konteksti i punës

Në këtë ndarje janë shënuar objektivat e institucionit dhe objektivat e Programit të Njësive Organizative për periudhën 1.7.2024 – 31.12 2024.

Ndarja C: Objektivat dhe matësit e performancës

Në këtë ndarje janë shënuar objektivat dhe matësit e performancës për periudhën 1.7.2024 – 31.12.2024, nga zyrtari i ngarkuar me këtë detyrë në aktin nënligjor.

Në këtë ndarje, e cila ka 6 rubrika vlerësimi, në 2 rubrika nëpunësi është vlerësuar nga zyrtari raportues me nivelin **3** “*Kënaqshëm*” dhe në 4 rubrika është vlerësuar me **1** “*Shumë mirë*”, duke evidentuar komentet përkatëse në secilën rubrikë.

Ndarja Ç: Sjellja profesionale

Në këtë ndarje, e cila ka 6 rubrika vlerësimi, në 2 rubrika nëpunësi është vlerësuar nga zyrtari raportues në nivelin **3** “*Kënaqshëm*”, në 3 rubrika është vlerësuar me nivelin **2** “*Mirë*”, ndërsa në një rubrikë është vlerësuar me nivelin **1** “*Shumë mirë*”, duke argumentuar në rubrikën komente arsyet e këtij vlerësimi.

Më tej, në cilësinë e palës që **ka përcaktuar objektivat e punës, matësit e performancës dhe sjelljen e vlerësueshme profesionale** (në fillim të faqes 7 të formularit), ka nënshkruar formularin Sekretari i Përgjithshëm, i Ministrisë së Drejtësisë, pasi në rastin në fjalë, referuar strukturës dhe organikës në fuqi të institucionit, të tre zyrtarët vlerësues: raportues/ zyrtari kundërfirmues/ autorizues, përfaqësohen nga i njëjti zyrtar, si nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën e hierarkisë organizative nëpunësin e vlerësuar.

Në ndarjen vlerësimi i përgjithshëm i rezultateve në punë, nëpunësi është vlerësuar në nivelin **2** (*Mirë*).

Ndarja D: Nënshkrimi

Kjo nëndarje është plotësuar dhe nënshkruar nga Zyrtari Raportues dhe Zyrtarit Kundërfirmues/ Autorizues, në datën 15.1.2025.

Nëpunësi i vlerësuar Alfred Çaushti, ka vënë shënimin tek rasti “*Nuk jam dakord me vlerësimin*”.

Në kushtet kur nëpunësi Alfred Çaushti, nuk e ka pranuar vlerësimin, ai ka kërkuar rivlerësim nga ana zyrtarit autorizues dhe rishqyrtim të procesit të vlerësimit, fakt që gjen pasqyrim në kërkesën e dërguar me shkresën nr. 02/2 prot., datë 7.2.2025, “*Kundërshtimi i vlerësimit të Drejtorit të ASHSGJ, nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues nga eprori direkt, Sekretari i Përgjithshëm i MD*”, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm, të Ministrisë së Drejtësisë, i cili është në cilësinë e zyrtarit autorizues.

Në vijim, zyrtari autorizues, bazuar në pikën 2, të kreut V, të aktit nënligjor të sipërcituar, pasi ka shqyrtuar ankimin e nëpunësit, ka kryer të njëjtin vlerësim, me nivelin **2** “*Mirë*”, duke e pasqyruar qëndrimin në pikën 1, të nëndarjes DH, të formularit të vlerësimit. Për këtë fakt, është njohur edhe nëpunësi me shkresën nr. 1225 prot., datë 26.2.2025, të Zv/Ministrit të Drejtësisë, dërguar pranë Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor.

Nisur nga gjithë sa më sipër, arrihet në përfundimin se, procesi i vlerësimit dhe rivlerësimit të nëpunësit Alfred Çaushti, për periudhën 1 Korrik- 31 Dhjetor 2024, është një proces

administrativ i rregullt për nga pikëpamja procedurale, pasi janë respektuar rregullat e përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil, për vlerësimin e nëpunësve civilë.

Nisur nga analiza formale e shkresës nr. 02/4 prot., datë 6.3.2025, (e protokolluar pranë Komisionerit me nr. 75/3 prot., 7.3.2025), me të cilën nëpunësi Alfred Çaushti ka dërguar informacionin, konstatohet se në të, është përdorur vula zyrtare e institucionit.

Në lidhje me këtë fakt, vlerësojmë se, çdo përdorim i vulës zyrtare duhet të bëhet vetëm në funksion të detyrës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përdorimi i vulës zyrtare për qëllime personale, përfshirë edhe paraqitjen e ankesave individuale, si në këtë rast, përbën shkelje të rregullave administrative dhe nuk duhet të lejohet.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ dhe arkivimin e çështjes, të filluar në bazë të informacionit nr. 75/3 prot., 7.3.2025, të paraqitur nga nëpunësi Alfred Çaushti, me objekt verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit, me detyra specifike gjatë realizimit të procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, meqënëse procesi i vlerësimit të rezultateve në punë është kryer në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil.
2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Ministrisë së Drejtësisë, si dhe nëpunësi Alfred Çaushti.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha